



RAPORT I GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2025 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E MBROJTJES

Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit (gjashtë-mujor) vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.

1. Përmbledhja ekzekutive

Gjatë periudhës Janar–Qershor 2025, Ministria e Mbrojtjes (në vijim: MM) ka përmbushur plotësisht detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, duke realizuar në masën 100% procesin e konsultimit publik për aktet e miratuara në këtë periudhë.

Janë konsultuar dhe miratuar dy projektligje si më poshtë:

- Projektligji “Për rezervat materiale të shtetit”;
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Ndërkohë, janë zhvilluar konsultime publike, përmes publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENjKP), si edhe nëpërmjet takimeve me aktorë të interesit, për projektakte të cilat janë ende në proces miratimi:

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Strategjia Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj.

Procesi i konsultimit publik është zhvilluar në përputhje me standardet ligjore dhe parimet e transparencës, përfshirjes dhe aksesueshmërisë për grupet e interesit. Përveç publikimit elektronik, MM ka organizuar takime të drejtpërdrejta me palët e interesuara, për të siguruar një dialog konstruktiv dhe përfshirës gjatë shqyrtimit të akteve të sipërpërmendura.

Edhe në këtë periudhë raportimi, Ministria e Mbrojtjes ka vijuar me angazhimin e saj për të respektuar në mënyrë të vazhdueshme praktikatat e konsoliduara të konsultimit publik, duke ruajtur një qasje të hapur dhe të qëndrueshme ndaj procesit të hartimit të akteve normative.

2. Analiza e konsultimeve të kryera


2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat Ministria e Mbrojtjes ka zhvilluar proces konsultimi publik gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 është 2, konkretisht:

- Projektligji “Për rezervat materiale të shtetit”;
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

MM ka miratuar 27 akte në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, nga të cilat 24 akte janë projektvendime dhe 2 projektligje, ndërsa 1 prej tyre është klasifikuar “Konfidencial”.



2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

2 (dy) akte i janë nënshtuar procesit të konsultimit publik. Në lidhje me pjesën tjetër të akteve të cilat janë miratuar, konkretisht 25 prej tyre, nuk kanë qenë objekt i konsultimit publik në përputhje me parashikimet e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Janë konsultuar 2 (dy) projektligje me raport VNR, konkretisht:

1. Projektligji "Për rezervat materiale të shtetit";
2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Në lidhje me projektaktet e tjera të miratuara gjatë kësaj periudhe, 25 prej tyre nuk janë objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45, në Kreun VI të VKM nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar. kanë qenë objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45/1, shkronja a) në Kreun VI të VKM Nr.584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar, që përcakton se përjashtohen nga detyrimi i kryerjes së vlerësimit të ndikimit:

a) Projektakte që trajtojnë çështje, të cilat lidhen me informacionin e klasifikuar shtetëror, çështje të sigurisë kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare të sigurisë.

2.1.4. *Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përfjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?*

Për 30 aktet e parashikuara në Programin Analitik gjatë vitit 2025, për 24 prej tyre janë përdorur kriteret e përfjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, pasi nuk janë në listën shteruese për të cilën është i detyruar konsultimi publik.

Për 3 aktet e parashikuara në PKIE, aplikohen kriteret e përfjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të Ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

2.1.5 *Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?*

Aktet e konsultuara janë 2 projektligje.

2.1.6 *A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?*

Në krahasim me një vit më parë, vihet re një përmirësim i ndjeshëm në performancën institucionale për sa i përket konsultimeve publike. Këtë vit, është shtuar ndjeshëm numri i akteve të konsultuara, si nëpërmjet Regjistrisë Elektronike për Njoftimin dhe Konsultimin (RENJK), ashtu edhe përmes organizimit të takimeve të drejtpërdrejta me grupet e interesit. Krahas rritjes së numrit të konsultimeve fizike në të dyja fazat e procesit – paraprake dhe publike – përmirësimi lidhet gjithashtu me rritjen e kapaciteteve institucionale për organizimin e konsultimeve të drejtpërdrejta, çka ka ndikuar në zhvillimin më të rregullt dhe më të strukturuar të takimeve me grupet e interesit. Njëkohësisht, përdorimi i platformave online ka vijuar të mbështesë procesin, duke mundësuar përfshirje më të gjerë dhe transparente.

2.2. *Metodat e konsultimit*

2.2.1. *Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)*

Metodat e konsultimit të dy projektakteve të miratuara ishin si më poshtë:

- **Puublikim në RENJK**, ku u vendos një afat 20 ditor (ditë pune) për dhënien e sugjerimeve/komenteve mbi draftin e dokumentit.
- **Nëpërmjet adresës së emailit:** konsultim.publik@mod.gov.al.

Me qëllim lehtësimin e dhënies së komenteve/sugjerimeve nga çdo i interesuar, në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, në rubrikën e dedikuar për konsultimin publik, krahas drafteve të projektligjit është vënë në dispozicion edhe një adresë elektronike.

- **Nëpërmjet adresës postare: “Rruga e Dibrës, Garnizoni “Skënderbej”, Tiranë:**

Çdo palë e interesuar pati mundësinë të dërgojë në formë shkresore, në adresë të Ministrisë së Mbrojtjes të gjitha komentet/sugjerimet mbi përmbajtjen e projektligjit.

- **Nëpërmjet zhvillimit të takimeve të drejtpërdrejta:**

Projektligjet e miratuara janë hartuar nga Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, në bashkëpunim me Komandat e Forcave dhe ato mbështetëse të Forcave të Armatosura.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda e cila gjeneroi më shumë komente ishte nëpërmjet publikimit në regjistrin elektronik të konsultimit publik, duke gjeneruar 1 (një) koment.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Po, Ministria e Mbrojtjes organizoi takime paraprake për 2 (dy) aktet e konsultuara dhe miratuara, me grupet e interesit, konkretisht strukturat dhe institucionet në varësi të tij për të diskutuar të gjitha projektaktet përpara se të fillonte me hartimin e draftit të tyre.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për aktet e miratuara dhe konsultuara gjatë vitit 2025 u realizua në përputhje me ligjin nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij, si më poshtë:

1. Projektligji "Për rezervat materiale të shtetit", u publikua në RENJKP nga data 18.06.2024-16.07.2024.
2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, u publikua në RENJKP nga data 21.10.2024-18.11.2024.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Konsultimi publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) për të gjitha aktet e planifikuara gjatë vitit 2025, u realizua në përputhje me ligjin nr. 146/2014 “Për

Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij. Konsultimet patën një kohëzgjatje prej 20 ditë pune duke filluar nga data e publikimit.

Kurse kohëzgjatja mesatare e projektakteve të konsultuara nëpërmjet të gjitha metodave të konsultimit, duke përfshirë dhe konsultimin paraprak, ka qenë afërsisht 3 muaj.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Po, situata këtë vit mund të konsiderohet e përmirësuar në raport me vitet e mëparshme. Ky përmirësim lidhet me një angazhim më aktiv të koordinatorit të procesit të konsultimit publik pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Një faktor ndikues ka qenë edhe zhvillimi i trajnimeve të posaçme, të cilat kanë ndihmuar në rritjen e vetëdijes për rëndësinë e këtij procesi dhe kanë mundur një menaxhim më efikas të tij. Bashkëpunimi me strukturat teknike përgjegjëse për hartimin e akteve ka qenë më i frytshëm, duke lehtësuar identifikimin dhe përfshirjen e grupeve të interesit në procesin e konsultimit dhe kontribuar kështu në një proces më gjithëpërfshirës dhe efektiv.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Në hartimin e Projektligjit "Për rezervat materiale të shtetit", kanë marrë pjesë drejtoritë operative të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, si dhe grupi i punës i ngritur me urdhrin e ministrit të Mbrojtjes nr.1765, datë 26.09.2023, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”, i ndryshuar.

Nisur nga problematikat e hasura gjatë zbatimit të ligjit aktual gjatë situatave jo të zakonshme, projektakti ka synuar të trajtojë dhe të japë zgjidhje mekanizmave për plotësimin, shpërndarjen, freskimin dhe mirëmbajtjen e mallrave, në zbatim të së cilave pritet të hartohen aktet e reja nënligjore.

Në hartimin e Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, Ministria e Mbrojtjes; Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura; Komandat e Forcave; Komandat Mbështetëse.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHK, kompani, etj.)

Aktet të cilat i janë nënshtruar konsultimit publik janë diskutuar nëpërmjet mbledhjeve të zhvilluara me anëtarët e grupit të punës, me strukturat në varësi të MM dhe SHPFA.

Ekspertë dhe aktorë të jashtëm nuk ka patur.

2.4.3 *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Gjatë procesit të konsultimit për dy projektligjet e miratuara dhe konsultuara është dhënë 1 (një) koment nga një qytetar.

2.4.4 *Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

Pjesa më e madhe e komenteve janë përcjellë kryesisht nga konsultimi teknik me Ministrinë e linjës: MF, MB, SHISH, MD, MIE, DAP, MEPJ, MSHSKB, MEKI, AKP, MSHPV dhe MSHMS. Gjithashtu gjatë fazës paraprake pati sugjerime dhe kontribut edhe nga Ushtarakë pjesëmarrës në operacione kombëtare dhe ndërkombëtare dhe stafe akademike të institucioneve arsimore dhe studimore të FARSH.

2.4.5 *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të shikueshmërisë të përfutur nga Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, ku gjatë gjashtëmujorit të parë numri i vizitorëve ka qenë 2185 vizitorë, nga 1900 vizitorë në gjashtëmujorin e parë i vitit 2024.

2.5. *Rekomandimet dhe komentet e marra*

2.5.1. *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

Nga konsultimi përmes Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet, ka pasur 1 (një) koment për aktet e konsultuara dhe miratuara sipas kësaj metode.

2.5.2. *Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

Në total është marrë 1 koment, i cili është refuzuar.

2.5.3. *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Krahasuar me vitet e kaluara, ku takimet publike ishin metoda që gjeneronte numrin më të madh të komenteve, kjo periudhë nuk ishte në një gjendje të kënaqshme, duke qenë se përfshirja e publikut nuk ishte në nivel ndikues.

2.5.4. *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

Raporti i VNR nuk është përditësuar në përfundim të procesit të konsultimit pasi reagimet e mbledhura nuk ndryshojnë implikimet e politikës së krijuar.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Gjatë periudhës Janar-Qershor të vitit 2025, Ministria e Mbrojtjes ka publikuar 2 (dy) raporte konsultimi publik.

2.6.2 Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Nuk kemi raporte konsultimi publik të pa publikuara. Aktualisht nuk kemi në proces konsultimi publik asnjë projektakt.

2.7 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Sa i përket këtyre projektakteve të konsultuara dhe miratuara gjatë gjashtëmujorit të parë 2025, bëjmë me dije se është respektuar me rigorozitet procedura dhe kërkesat e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”:

- projektaktet janë publikuar në RENJK;
- është dhënë informacion i mjaftueshëm;
- janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre;
- në draftin e ri pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimit të palëve të interesuara lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit;
- është respektuar afati 20 ditor.

Për këtë arsye, Ministria e Mbrojtjes është vetëvlerësuar me pikët maksimale (8) për 5 projektligjet për të cilët procesi i konsultimit publik ka përfunduar.

3 Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Edhe pse procesi i konsultimit publik është tashmë një praktikë e konsoliduar, ai vazhdon të përballë me disa sfida, kryesisht në drejtim të përfshirjes sa më të gjerë të publikut. Gjithsesi, vihet re një përmirësim i ndjeshëm i ndërgjegjësimit për këtë proces, çka dëshmohet edhe nga rritja e numrit të vizitave dhe komenteve në RENJK. Përdorimi i kësaj platforme ndihmon në garantimin e transparencës dhe monitorimit efektiv nga Kryeministria, duke i dhënë më shumë peshë dhe përgjegjësi reflektimit të komenteve të dërguara përmes saj.

Për më tepër, përveç angazhimit të publikut, është thelbësore të përforcohet edhe roli i strukturave teknike hartuese të akteve. Kjo kërkon informim dhe ndërgjegjësim të vazhdueshëm përmes trajnimeve të dedikuara, me synimin që ato të jenë më të vetëdijshme për rëndësinë e procesit të

konsultimit publik dhe të kontribuojnë aktivisht në të gjitha fazat e tij. Këto masa do të ndikojnë pozitivisht në rritjen e cilësisë së procesit dhe të performancës institucionale.

Me qëllim përmirësimin e cilësisë së procesit, synohet sërish ndërgjegjësimi edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik, në përshtatje me zhvillimet më të fundit të mjeteve të informacioni.